

Njoftim !

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.16, datë 16.1.2019 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qendrore” shpall kërkesën për punonjës me kontratë të përkohshme, me kohëzgjatje deri në 31 Dhjetor 2019, me kohë pune 6 orë në ditë për sa më poshtë:

I – Pozicionet

- Punonjës arkive 3 persona
- Biblotekar 1 person

II – Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët:

- Kërkesën për aplikim duke përcaktuar pozicion për të cilin aplikon;
- Curriculum Vitae të përditësuar, modeli Europass, me datën dhe firmën e personit;
- Fotokopje të pashaportës ose kartës së identitetit;
- Fotokopje të diplomës;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj
- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore
- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;

Dokumentacioni i mësipërm duhet sjellë pranë zyrave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, në adresën; Rr.”Ibrahim Rugova”, Garda e Republikës, brenda datës **14/2/2018**.

III - Kërkesat që duhet të plotësojnë kandidatët:

III-1 Kandidatët për punonjës arkive:

- Të kenë përfunduar studimet e larta (bachelor), preferohet në degën histori/arkivistikë;
- Të kenë përvojë pune në sekretari/protokoll/arkiv, ose eksperiencë të ngjashme
- Të kenë njohuri shumë të mira mbi sistemin Windows dhe programet MS Office;
- Të jenë të aftë dhe të gatshëm për të punuar në grup, dhe të përballen me detyrat e punës nën presion
- Përvoja e punës në administratën shtetërore përbën avantazh.

III-2 Kandidatët për bibliotekarë:

- Të kenë përfunduar studimet e larta (bachelor), preferohet në degët; gjuhë, letërsi, gjuhë të huaj;
- Të kenë eksperiencë pune të ngjashme në lidhje me:
 - mënyrën e organizimit të bibliotekave;
 - mënyrën e regjistrimit, indeksimit, katalogimit, inventarizimit;
 - sistemet e identifikimit dhe kërkimit.
- Të kenë njohuri të mira mbi sistemin Windows dhe programet MS Office;
- Të jenë të aftë dhe të gatshëm për të punuar në grup, dhe të përballen me detyrat e punës nën presion;
- Përvoja e punës në administratën shtetërore përbën avantazh.

IV – Përzgjedhja e kandidatëve:

- Përzgjedhja fillestare e kandidatëve do të bëhet mbi bazen e dokumentave të paraqitura brenda datës **15/2/2019;**
- Të gjithë kandidatët do të njoftohen me email për rezultatet e përzgjedhjes brenda datës **15 / 2/2019;**
- Kandidatët e përzgjedhur nga faza e mësipërme do të nënshtrohen një interviste me gojë,
- Kandidatët fitues do të njoftohen me email, për të vazhduar me kompletimin e dokumentacionit dhe nënshkrimin e kontratës të punës brenda datës **18/2/2019.**